



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep: D.P	No. Prot: 01-4195/1a
Dep: D.P	Prot. No: 01-4195/1a
Nr. Titull: _____	Data: 28.10.2011
Isori shpreh: _____	Datum: 28.10.2011
Nr. faqe: _____	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 45 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.10.2011 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti i konfliktit të interesit me numër protokoli AKK –03-3105/11, për z. **Behxhet Pacolli** – Zv.Kryeministër në Qeverinë e Republikës së Kosovës
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti me numër protokoli AKK-03-3105/11, është trajtuar nën dyshimin e bazuar për konflikt të mundshëm të interesit, me veprimet e nevojshme ligjore (Ligji Nr. 04/L-051) dhe atyre procedurale (Neni 18, pika 1). Pas identifikimit të rastit me dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit, Zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese (04.07.2011) të cilës zyrtari i lartë, përmes Këshilltareve të tij i është pergjegjur me datën 14.07.2011 . Në takimin e mbajtur mes zyrtareve të Agjencisë dhe Këshilltarëve të autorizuar të Zyrtarit të Lartë të përfshirë në këtë rast kemi elaboruar dhe sqaruar në detaje pse i është bërë shkresa njoftuese dhe pse ka dyshim të bazuar për konflikt interesi. Këshilltarët e Zyrtarit të lartë, nga faktet e prezantuara , gjithnje në pajtim dhe duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konflikti të Interesit, u bindën për ekzistimin e situatës konflikt interesi dhe pas këshillave që u janë dhënë për mënyren e shmangies së kësaj shtate ata premtuan se do të nisin këtë procedurë sa më parë.

Me datën 12.10.2011 Zyrtari i lartë është kontaktuar përsëri (Këshilltarët e tij) dhe nga ta është marr njoftimi se ndryshimet janë bërë dhe ato do të na dërgohen së shpejti në AKK.

Kjo ka ndodhur me datën 13.10.2011 kur kemi pranuar shkresën njoftuese me informacionet zyrtare nga MTI me ndryshimet e bëra mbi biznesin në fjalë.

Prandaj në bazë të këtyre veprimeve të kryera u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit të DP-së
- Shefit të Divizionit
- Zyrtarit të Lartë, Behxhet Pacolli,
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Hasan Preteni /